

VENDIM
Nr. 35, datë 14.11.2025

**PËR NJË SHITESË NË “RREGULLOREN E LICENCIMIT PËR PROCEDURAT E
DHËNIES DHE RINOVIMIT TË LICENCAVE PROFESIONALE PËR SUBJEKTET
JURIDIKE E FIZIKE QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË SEKTORIN E FURNIZIMIT
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikave “e” dhe “i”, të nenit 14, të pikës 1, të nenit 17 dhe pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 14.11.2025, pasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike - Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit

KONSTATON SE:

1. Komisioni Kombëtar Rregullator ka kompetencën e licencimit të personave fizikë dhe juridikë që ushtrojnë apo do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, në përputhje me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, të ndryshuar, si dhe të drejtën të modifikojë apo të bëjë amendamente në licenca.

2. Praktika aktuale e licencimit, veçanërisht për rastet e ndryshimit të elementeve të vendimit të licencimit brenda afatit të vlefshmërisë, kërkon qartësim dhe unifikim të procedurës për aplikim dhe administrimin e dokumentacionit të ndryshuar.

Për sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se shtesa në rregulloren licencimit do të përmirësojë procedurën e licencimit në kushtet e ndryshimeve të elementeve të licencës:

VENDOSI:

1. Në rregulloren e licencimit për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, shtohet neni 11/1, si më poshtë:

“Neni 11/1

Në rastet e ndryshimit të elementeve të vendimit të licencës, brenda periudhës së vlefshmërisë, operatori duhet që 30 ditë nga momenti i këtij ndryshimi të paraqes kërkesën për ndryshim pranë ERRU-së. Në zbatim të pikës 2, të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, të ndryshuar, ku është listuar dokumentacioni i nevojshëm për licencim, operatori duhet të paraqesë vetëm dokumentacionin e ndryshuar. Dokumentacioni i cili nuk ndryshon, do të administrohet nga dosja e aplikimit të licencës.”.

2. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Gerta Lubonja